VENDIM
Nr. 81, datë 6.4.2018

MBI MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR SIGURIMIN E AKSESIT TË PALËVE TË TRETA NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT DHE TRANSPARENCËN NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; të nenit 42, pika 3 dhe të nenit 48, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror"; të nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe parashikimeve të vendimit nr. 2018/01/PHLG-EnC, datë 12.1.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror",

konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 42, pika 3, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", ERE miraton rregullat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror.
- "Draftrregullat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror", janë hartuar në përputhje me referencat në Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 715/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 31, datë 9.2.2018, filloi procedurën për miratimin e "Rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencës në sektorin e gazit natyror".
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE ka vijuar me publikimin me media të njoftimit nr. 55/5 prot., datë 12.2.2018, për fillimin e procedurës për miratimin e "Draftrregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencës në sektorin e gazit natyror", me qëllim marrjen e komenteve nga palët e interesit.
- Me shkresën nr. 192 prot., datë 9.2.2018, ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Konkurrencës dhe "Albgaz" sh.a.
- ERE, në datën 19.2.2018, ka dërguar, gjithashtu, në formë elektronike këtë draft pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për të marrë komentet e tij.
- Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe të opinioneve nga palët rezultoi se mbi këtë praktikë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës dhe "Albgaz" sh.a.
- Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 129/1 prot., datë 21.3.2018, ka përcjellë në ERE komentin, se "Draftrregullat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyor", nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.20103, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar.
- "Albgaz" sh.a., me shkresën nr. 44 prot., datë 21.3.2018, ka shprehur vlerësimin dhe dakordësinë e saj në lidhje me fillimin e procedurës për vendimin e sipërcituar në zbatim të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë "Rregullat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror".

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLAT
PËR SIGURIMIN E AKSESIT TË PALËVE TË TRETA NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT DHE TRANSPARENCËN NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Objekti

- Këto rregulla hartohen në zbatim të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror"; të ligjit nr. 9501, datë 3.4.2006, "Për ratifikimin e traktatit për krijimin e komunitetit të energjisë"; të Rregullores (KE) nr. 715/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës; të vendimit të Komisionit të BE-së nr. 2010/685, të datës 10 nëntor 2010 dhe të vendimit nr. 2018/01/PHLG-EnC, datë 12.1.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë.

- Ky akt përcakton tërësinë e rregullave mbi procedurat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe kërkesat për të dhëna lidhur me publikimin në kohë të të dhënave mbi transmetimin, shpërndarjen furnizimin, operimin në hapësirat e depozitimit, operimin në impiantet e GNL-së dhe tregun balancues si të dhëna kyçe të tregut dhe, njëkohësisht disponibilitetin e tyre për të gjithë pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror, si një parakusht për funksionimin e tregut në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.

- Gjithashtu përcakton në mënyrë të detajuar detyrimet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të pjesëmarrësve të tjerë të tregut, në lidhje me publikimin e të dhënave të tregut gazit natyror dhe të çështjeve të tjera të nevojshme për publikimin e tyre.

1. Shërbimet për aksesin e palëve të treta në Operatorin e Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të ofrojë shërbime të qëndrueshme dhe të ndërprera për një periudhë minimumi një ditë.

2. Kontratat e harmonizuara të transmetimit dhe kodet e përbashkëta të rrjetit duhet të hartohen në mënyrë që të lehtësojnë tregtimin dhe ripërdorimin e kapacitetit të kontraktuar nga përdoruesit e rrjetit pa penguar lirimin e kapacitetit *(capacity release)*.

3. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të zhvillojnë kodet e rrjetit dhe kontratat e harmonizuara pas konsultimeve me përdoruesit e rrjetit.

4. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të zbatojnë procedurat e standardizuara për emërimin dhe riemërimin. Ata duhet të hartojnë sisteme informimi dhe mjete të komunikimit elektronik për të ofruar të dhënat e duhura për përdoruesit e rrjetit dhe për të lehtësuar transaksionet, siç janë: emërimi, kontraktimi i kapacitetit dhe transferimi i të drejtave të kapacitetit midis përdoruesve të rrjetit.

5. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të harmonizojnë procedurat për formalizimin e kërkesës dhe afatet për të kthyer përgjigje, sipas praktikave më të mira të industrisë për të minimizuar afatet për përgjigje. Ata duhet të ofrojnë rezervimin e kapacitetit *online*. Sistemet e konfirmimit dhe procedurat e emërimit/ riemërimit, jo më vonë se data 1 korrik 2018, pasi të jenë konsultuar me

përdoruesit përkatës të rrjetit.

6. Operatorët e sistemit të transmetimit nuk duhet të tarifojnë në mënyrë të veçantë përdoruesit e rrjetit për kërkesat për informacion dhe transaksionet që lidhen me kontratat e transmetimit, të cilat janë kryer sipas rregullave dhe procedurave standarde.

7. Kërkesat për informacion, të cilat kërkojnë shpenzime të veçanta ose shtesë, të tilla si studimet e fizibilitetit mund të tarifohen të veçuara, në mënyrë që pagesat të argumentohen dhe të justifikohen siç duhet.

8. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të bashkëpunojnë me operatorët e tjerë të transmetimit për të koordinuar mirëmbajtjen e rrjeteve, në mënyrë që të minimizojnë çdo ndërprerje të shërbimeve të transmetimit për të siguruar përfitime të barabarta në lidhje me sigurinë në furnizim përfshirë edhe transitin.

9. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të publikojnë të paktën një herë në vit, sipas një afati të caktuar, të gjitha periudhat e planifikuara të mirëmbajtjes të cilat mund të ndikojnë në të drejtat e përdoruesve të rrjetit nga kontratat e transmetimit dhe informacionin operacional përkatës me njoftimin paraprak. Kjo do të përfshijë publikimin e menjëhershëm dhe jodiskriminues të ndonjë ndryshimi për periudhat e planifikuara të mirëmbajtjes dhe njoftimin për mirëmbajtjet e paplanifikuara, kur ky informacion të vihet në dispozicion të Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Gjatë periudhave të mirëmbajtës, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të publikojnë në mënyrë të rregullt informacion të përditësuar për detajet, kohëzgjatjen dhe efektet e mirëmbajtjes.

10. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të mbajnë dhe të vënë në dispozicion me kërkesë të autoriteteve kompetente një regjistër ditor të përditësuar, për mirëmbajtjen dhe ndërprerjet që kanë ndodhur. Informacioni do të vendoset në dispozicion sipas kërkesës për ata që efektohen nga ndërprerjet.

2. Parimet e mekanizmave për ndarjen e kapaciteteve dhe procedurat për menaxhimin e kongjestioneve në lidhje me operatorët e sistemit të transmetimit dhe aplikimin e tyre në rast të kongjestioneve kontraktuale

2.1 Parimet e mekanizmave për ndarjen e kapaciteteve dhe të procedurave për menaxhimin e kongjestioneve në lidhje me operatorët e sistemit të transmetimit

1. Mekanizmat e alokimit të kapaciteteve dhe procedurat e menaxhimit të kongjestioneve do të lehtësojnë zhvillimin e konkurrencës dhe tregtimin e produkteve për kapacitetet dhe duhet të jenë në përputhje me mekanizmat e tregut përfshirë tregun spot (tregun në kohë reale) dhe qendrat tregtare. Ata duhet të jenë fleksibël dhe të jenë në gjendje të përshtaten me rrethanat e zhvillimit të tregut.

2. Këta mekanizma dhe procedura duhet të marrin në konsideratë të gjithë sistemin e përfshirë si dhe sigurinë e furnizimit.

3. Këta mekanizma dhe procedura as nuk do të pengojnë hyrjen e pjesëmarrësve të rinj në treg dhe as nuk do të krijojnë pengesa të panevojshme për të hyrë në treg. Ata nuk do t'i ndalojnë pjesëmarrësit e tregut, përfshirë pjesëmarrësit e rinj të tregut dhe kompanitë me aksione të vogla në treg, që të konkurrojnë në mënyrë efektive.

4. Këta mekanizma dhe procedura duhet të ofrojnë sinjalet e duhura ekonomike për përdorim efektiv dhe maksimal të kapaciteteve teknike dhe të lehtësojnë investimet tek infrastruktura e re.

5. Përdoruesit e rrjetit duhet të këshillohen për tipin e rrethanës që mund të ndikojë në disponueshmërinë e kapacitetit të kontraktuar. Informacioni për ndërprerjen duhet të reflektojë nivelin e informacionit në dispozicion të operatorit të sistemit të transmetimit.

6. Nëse vështirësitë në përmbushjen e detyrimeve të shpërndarjes ndodhin për shkak të integritetit të sistemit, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të njoftojnë përdoruesit e rrjetit dhe të kërkojnë zgjidhje jodiskriminuese dhe pa vonesa.

Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të konsultohen me përdoruesit e rrjetit në lidhje me procedurat para zbatimit të tyre dhe t'i dakordësojnë ato me autoritetin rregullator.

2.2 Procedurat e menaxhimit të kongjestioneve në rast të kongjestionit kontraktual

2.2.1 Dispozita të përgjithshme

1. Dispozitat e pikës 2.2 duhet të aplikohen për pikat e ndërlidhjes midis sistemeve të hyrje-daljes afër njëra-tjetrës, përveç nëse ato janë fizike ose virtuale, midis dy ose më shumë shteteve ose midis të njëjtit shtet për aq kohë sa pikat i nënshtrohen procedurës së rezervimit nga përdoruesit. Po ashtu, ato mund të aplikohen për pikat e hyrjes dhe të daljes për vendet e treta, sipas vendimit përkatës të autoritetit rregullator në vend. Pikat e daljes për konsumatorët fundorë të rrjetet e shpërndarjes, pikat e hyrjes nga terminalet e GNL-së dhe pajisjet e prodhimit dhe pikat e hyrjes dhe të daljes nga dhe për objektet e depozitimit, të cilat nuk paraqiten në dispozitat e pikës 2.2.

2. Në bazë të informacionit të publikuar nga operatorët e sistemit të transmetimit, sipas pjesës 3 të këtyre rregullave dhe kur është e përshtatshme, të vlefshme nga autoritetet rregullatore në vend, agjencia duhet të publikojë deri në datën 1 mars të çdo viti, duke filluar nga viti 2020, një raport monitorimi mbi kongjestionet në pikat e ndërlidhjes, në lidhje me produktet e konfirmuara të kapacitetit, të cilat janë shitur gjatë vitit në vijim, duke marrë në konsideratë shkallën e mundshme të tregtimit të kapaciteteve në tregun sekondar dhe përdorimin e kapacitetit të ndërprerjes.

3. Çdo kapacitet shtesë që do të vihet në dispozicion përmes aplikimit të një prej procedurave të menaxhimit të kongjestioneve, si jepet në pikat 2.2.2, 2.2.3, 2.2.4 dhe 2.2.5 duhet të ofrohen nga operatori (operatorët) respektiv(ë) në procesin e rregullt të ndarjes.

4. Masat e vendosura në pikat 2.2.2, 2.2.4 dhe 2.2.5 duhet të zbatohen duke filluar nga data 1 tetor 2018. Pikat nga 2.2.3(1) te 2.2.3(5) duhet të aplikohen deri në datën 1 korrik 2020.

2.2.2 Rritja e kapaciteteve përmes marrjes së më shumë blerësve *(oversubscription)* dhe skemës së blerjes më pas *(buy-back scheme)*

1. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet t'i propozojnë dhe pasi të miratohet nga autoriteti rregullator në vend, të zbatojnë nxitjen (incentivën), e cila bazohet te marrja e më shumë blerësve (*oversubscription*) dhe skema e blerjes më pas (*buy-back scheme*) për të konfirmuar kapacitetin shtesë. Para se ta zbatojë, autoriteti rregullator në vend duhet të konsultohet me autoritetet rregullatore të vendeve fqinje përkatëse në interkoneksion, për të marrë në konsideratë opinionet e autoriteteve rregullatore. Kapaciteti shtesë përcaktohet si kapacitet i konfirmuar, i ofruar përveç kapacitetit teknik për një pikë të interkoneksionit të përllogaritur në bazë të pikës 16(1) të këtyre rregullave.

2. Skema e marrjes së më shumë blerësve dhe skema e blerjes më pas duhet t'u ofrojnë operatorëve të sistemit të transmetimit një shtysë (incentivë) për të vendosur në dispozicion kapacitetin shtesë, duke marrë në konsideratë kushtet shtesë, si vlera kalorifike, temperatura dhe konsumi që pritet, për sistemin përkatës të hyrjes dhe të daljes dhe kapacitetet për rrjetet përkatëse. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të aplikojnë për një mënyrë dinamike në lidhje me rillogaritjen e kapacitetit teknik ose shtesë për sistemin e hyrje-daljes.

3. Këto skema do të bazohen në një regjim incentivash që reflektojnë rreziqet e operatorëve të sistemit të transmetimit në ofrimin e kapacitetit shtesë. Skema duhet të strukturoret në atë mënyrë që të ardhurat nga shitja e kapacitetit shtesë dhe kostot nga skema e blerjes më pas *(buy-back scheme)* ose masat sipas paragrafit 6, janë ndarë midis operatorëve të sistemit të transmetimit dhe përdoruesve të rrjetit. Autoritetet rregullatore duhet të vendosin për ndarjen e të ardhurave dhe kostove midis operatorit të sistemit të transmetimit dhe përdoruesit të rrjetit.

4. Për të përcaktuar të ardhurat e operatorit të sistemit të transmetimit, kapacitetin teknik dhe veçanërisht kapacitetin e hequr dorë *(surrendered capacity),* si dhe kur është e përshtatshme kapacitetin që vjen nga aplikimi i konfirmuar "përdore ose humbe" të një dite në avancë *(day-ahead use-it-or- lose-it)* dhe mekanizmi afatgjatë "përdore ose humbe" *(long term use-it-or-lose-it mechanisms)*, duhet të konsiderohen për t'u alokuar më përparësi për çdo kapacitet shtesë.

5. Në përcaktimin e kapacitetit shtesë, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të marrë në konsideratë skenarët statistikorë për sasitë e mundshme të kapacitetit fizik të papërdorur në një kohë të

caktuar në pikat e interkoneksionit. Po ashtu, duhet të marrë në konsideratë një profil risku për ofrimin e kapacitetit shtesë, i cili nuk çon në detyrimin për të blerë më pas pjesën e tepërt. Skemat e marrjes së më shumë blerësve dhe ajo e blerjes më pas, duhet të vlerësojnë parashikimet dhe kostot për blerjen përsëri të kapacitetit në treg dhe ta reflektojnë këtë në shumën e kapacitetit shtesë për t'u vënë në dispozicion.

6. Në rastet kur është e nevojshme për të mbajtur tërësinë e sistemit, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të aplikojnë procedurën e cila bazohet në treg të blerjes më pas *(buy back)* ku përdoruesit e rrjetit mund të ofrojnë kapacitet. Përdoruesit e rrjetit duhet të informohen për aplikimin e procedurës së blerjes më pas *(buy back)*. Aplikimi i kësaj procedure blerjeje nuk ndikon në aplikimin e masave emergjente.

7. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet që, para se ta zbatojnë procedurën e blerjes më pas *(buy back)*, të verifikojnë masat alternative teknike dhe tregtare për të mbajtur integritetin e sistemit në mënyrën më eficiente për kostot.

8. Kur propozohen skemat e marrjes së më shumë blerësve dhe ajo e blerjes më pas, operatori i sistemit të transmetimit duhet të ofrojë të dhënat përkatëse, vlerat dhe modelet për autoritetet rregullatorë, në mënyrë që ky i fundit të aksesojë skemën. Operatori i sistemit të transmetimit duhet të raportojë në mënyrë të rregullt tek autoriteti rregullator për funksionimin e skemës dhe sipas kërkesës së autoritetit rregullator të ofrojë të dhënat përkatëse. Autoriteti rregullator mund t'i kërkojë operatorit të sistemit të transmetimit që ta rishikojë skemën.

2.2.3 Konfirmim i mekanizmit të një dite në avancë "përdore ose humbe"

1. Autoritetet rregullatore në vend duhet t'u kërkojnë operatorëve të sistemit të transmetimit të aplikojnë të paktën rregullat që përcaktohen në paragrafin 3 për përdoruesit e rrjetit, në pikat e interkoneksionit, në lidhje me ndryshimin e emërimit të fillimit, nëse në bazë të raportit vjetor të monitorimit të agjencisë, sipas pikës 2.2.1(2), tregohet që në pikat e interkoneksionit kërkesa e tejkalon ofertën, në çmimin rezervë kur përdoren ankandet, sipas procedurës së ndarjes së kapaciteteve përgjatë vitit që mbulon raporti i monitorimit për produktet në përdorim të atij viti ose të dy viteve në vazhdim:

a) Për të paktën tri produkte kapaciteti të konfirmuara me një kohëzgjatje një muaj; ose

b) Për të paktën dy produkte kapaciteti të konfirmuara me një kohëzgjatje tremujore; ose

c) Për të paktën një produkt kapaciteti të konfirmuar me kohëzgjatje një muaj ose më shumë;

d) Në rastet kur nuk ka produkt kapaciteti të konfirmuar jepet një kohëzgjatje një muaj ose më shumë.

2. Nëse, në bazë të raportit vjetor të monitorimit, tregohet që një situatë, si përcaktohet në paragrafin 1, nuk do të përsëritet gjatë tri viteve të ardhshme, për shembull, si rezultat i kapacitetit që është në dispozicion nga shtimi fizik i rrjetit ose përfundimi i kontratave afatgjata, autoritetet rregullatore përkatëse mund të vendosin të përfundojnë konfirmimin e mekanizmit të një dite në avancë "përdore ose humbe". Ricaktim i konfirmuar lejohet mbi 90% dhe nën 10% të kapacitetit të kontraktuar nga përdoruesi i rrjetit në pikën e interkoneksionit. Megjithatë, nëse caktimi tejkalon 80% të kapacitetit të kontraktuar, gjysma e volumit të pacaktuar mund të ricaktohet në vazhdim. Nëse caktimi nuk e tejkalon 20% të kapacitetit të kontraktuar, gjysma e vëllimit të caktuar mund të ricaktohet më poshtë. Aplikimi i këtij paragrafi nuk ndikon në masat e emergjencës që aplikohen.

3. Zotëruesi i kapacitetit të kontraktuar mund të ricaktojë pjesën e kufizuar të kapacitetit të tij të konfirmuar sipas ndërprerjeve.

4. Paragrafi 3 nuk do të aplikohet për përdoruesit e rrjetit, personat ose kompanitë dhe kompanitë që ata kontrollojnë, sipas nenit 3 të Rregullores (BE) nr. 139/2004, e cila ka më pak se 10% të kapacitetit mesatar teknik gjatë vitit të mëparshëm në pikën e ndërlidhjes.

5. Në pikat e interkoneksionit ku aplikohet konfirmimi i mekanizmit të një dite në avancë "përdore ose humbe" *(a firm day-ahead use-it-or-lose-it mechanism)*, sipas paragrafit 3, duhet të kryhet një vlerësim për marrëdhënien me marrjen se më shumë blerësve *(oversubscription)* dhe skemën e blerjes më pas *(buy-back scheme)*, sipas pikës 2.2.2 nga autoriteti rregullator në vend, që mund të kthehet në vendim nga autoriteti rregullator që nuk zbatohet për dispozitat e pikës 2.2.2 për ato pika interkoneksioni.

6. Autoriteti rregullator mund të vendosë të zbatojë mekanizmin konfirmues të një dite në avancë

"përdore ose humbe" *(firm day-ahead use-it-or-lose-it mechanism)*, sipas paragrafit 3 në një pikë të interkoneksionit. Para se ta miratojë këtë vendim, autoriteti rregullator duhet të konsultohet me autoritetet rregullatore të vendeve fqinje. Për miratimin e këtij vendimi autoriteti rregullator duhet të marrë në konsideratë opinionet e autoriteteve rregullatore fqinje.

2.2.4 Kapacitet i kontraktuar i dorëzuar *(surrender)*

Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të pranojnë çdo kapacitet të konfirmuar të dorëzuar *(surrender)*, i cili është kontraktuar nga përdoruesi i rrjetit në pikën e ndërlidhjes, me përjashtim të produkteve të kapacitetit me afat një ditë ose më pak. Përdoruesi i rrjetit duhet të mbajë të drejtat dhe detyrimet e tij, sipas kontratës së kapacitetit derisa kapaciteti të rindahet nga operatori i sistemit të transmetimit. Kapaciteti i dorëzuar do të konsiderohet të rindahet vetëm pasi kapaciteti në dispozicion të ndahet. Operatori i sistemit të transmetimit duhet të informojë në kohë përdoruesin e rrjetit për çdo rindarje të kapacitetit të tij të dorëzuar. Afatet dhe kushtet e veçanta për kapacitetin e dorëzuar, veçanërisht për rastet kur përdorues të ndryshëm të rrjetit e dorëzojnë kapacitetin e tyre, duhet të miratohen nga autoritetet rregullatore në vend.

2.2.5 Mekanizmi "përdore ose humbe" afatgjatë

1. Autoritetet rregullatore në vend do t'u kërkojnë operatorëve të sistemit të transmetimit që në mënyrë sistematike të tërheqin plotësisht/ pjesërisht kapacitetin e kontraktuar të pashfrytëzuar në pikat e interkoneksionit nga përdoruesi i rrjetit ku përdoruesi nuk ka shitur ose ofruar sipas kushteve të arsyeshme kapacitetin e papërdorur dhe kur përdoruesit e tjerë të rrjetit kërkojnë kapacitet të konfirmuar. Kapaciteti i kontraktuar konsiderohet të jetë i pashfrytëzuar në mënyrë sistematike, veçanërisht nëse:

a) Përdoruesi i rrjetit përdor më pak se mesatarisht 80% të kapacitetit të tij të kontraktuar nga 1 prilli deri në datën 30 shtator dhe nga 1 tetor deri në 31 mars, me kohëzgjatje efektive të kontratës prej më shumë se një vit, për të cilin nuk mund të jepen arsyetimet e duhura; ose

b) Përdoruesi i rrjetit në mënyrë sistematike cakton afërsisht 100% të kapacitetit të tij të kontraktuar dhe ricakton edhe më pak, me qëllim shmangien e rregullave të përcaktuara në pikën 2.2.3(3).

2. Aplikimi i konfirmimit të mekanizmit të një dite në avancë "përdore ose humbe" do të shihet si justifikim për të parandaluar aplikimin e paragrafit 1.

3. Tërheqja do të çojë që përdoruesi i rrjetit të humbë pjesërisht/plotësisht kapacitetin e tij të kontraktuar për një periudhë të caktuar ose për afatin kontraktual të mbetur. Përdoruesi i rrjetit duhet të mbajë të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kapacitetit të kontratës, derisa kapaciteti të rindahet nga operatori i sistemit të transmetimit dhe të shtojë kapacitetin që nuk është rindarë nga operatori i sistemit të transmetimit.

4. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet t'u ofrojnë rregullisht autoriteteve rregullatore të gjitha të dhënat e nevojshme për të monitoruar shkallën, sipas së cilës kapacitetet e kontraktuara me kohëzgjatje të kontratës më shumë se një vit ose që përdoren periudha të përsëritura të cilat mbulojnë të paktën dy vjet.

3. Përcaktimi i informacionit teknik të nevojshëm për përdoruesit e rrjetit për të marrë akses në sistem, përcaktimi i të gjitha pikave përkatëse për kërkesat e transparencës dhe informacionin që do të publikohet në pikat përkatëse dhe programit, sipas të cilit ky informacion duhet të publikohet

3.1 Përcaktimi i informacionit teknik të nevojshëm për përdoruesit e rrjetit për të marrë akses në sistem

3.1.1 Forma e publikimit

1. Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST) duhet të ofrojnë të gjithë informacionin referuar në paragrafin 3.1.2 dhe paragrafin 3.3(1) deri 3.3(5), sipas mënyrës së mëposhtme:

a) Në faqen e internetit e cila është e aksesueshme pa pagesë dhe pa qenë nevoja për t'u regjistruar ose duke u lidhur me operatorin e sistemit të transmetimit;

b) Në mënyrë të rregullt, frekuenca do të jetë sipas ndryshimeve që ndodhin dhe kohëzgjatjes së shërbimit;

c) Me mirëkuptim të përdoruesit;

d) Në mënyrë të qartë, sasiore që aksesohet lehtë dhe në mënyrë jodiskriminuese;

e) Në një format i cili mund të shkarkohet që është dakordësuar midis operatorëve të sistemit të transmetimit dhe autoriteteve rregullatore në vend, sipas një opinioni në një format të harmonizuar që ofrohet nga agjencia dhe që i lejon analizat sasiore;

f) Në njësi të qëndrueshme, veçanërisht kwh (me një referencë për djegie temperatura 298,15 K) do të jetë njësia për përmbajtjen e energjisë dhe m^3 (në 273,15 K dhe 1,01325 bar) do të jetë njësia për vëllim. Duhet të ofrohet faktori konstant i konvertimit për përmbajtjen e energjisë. Përveç formatit të mësipërm është i mundur publikimi i njësive të tjera;

g) Në gjuhën (gjuhët) zyrtare shqipe dhe në gjuhën angleze;

h) Të gjitha të dhënat duhet të vendosen në dispozicion, duke filluar nga data 1 tetor pas anëtarësimit në ENTSOG, në platformën qendrore të ENTSOG-së

2. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të japin detaje mbi ndryshimet aktuale për të gjithë informacionin e referuar në paragrafin 3.1.2 dhe paragrafët nga 3.3(1) deri te 3.3(5), në një periudhë të caktuar sapo të vendoset në dispozicion të tyre.

3.1.2 Përmbajtja e publikimit

Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të publikojnë të paktën informacionin e mëposhtëm për sistemet dhe shërbimet e tyre:

a) Një përshkrim të detajuar dhe të kuptueshëm për shërbimet e ndryshme të ofruara dhe detyrimet përkatëse;

b) Llojet e ndryshme të kontratave të transportit në dispozicion për shërbimet e tyre;

c) Kodin e rrjetit dhe/ose kushtet standarde ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet për të gjithë përdoruesit e rrjetit përfshirë:

1. Kontratat e harmonizuara të transportit dhe dokumentet e tjera përkatëse;

2. Nëse është e nevojshme për akses në sistem, për të gjitha pikat përkatëse si përshkruhet në paragrafin 3.2 të këtyre rregullave, specifikim për parametrat përkatës të cilësisë së gazit, përfshirë vlerën kalorifike bruto dhe treguesin *Wobbe* dhe detyrimin ose kostot e konvertimit për përdoruesit e rrjetit në rast se gazi është jashtë këtyre specifikimeve;

3. Nëse është e përshtatshme për akses në sistem, për të gjitha pikat përkatëse nevojitet informacioni mbi kërkesat e presionit;

4. Procedura, në rast ndërprerjeje të kapacitetit të ndërprerë, përfshirë rastet kur aplikohet, kohën, zgjatjen dhe shkallën e ndërprerjeve individuale (për shembull, në mënyrë proporcionale *(pro-rata)* ose sipas "ai që vjen i pari ndërpritet i fundit" *(first-come-last-interrupted)*;

d) Procedurat e harmonizuara që aplikohen kur përdoret sistemi i transmetimit, përfshirë përcaktimin e termave kryesorë;

e) Dispozitat mbi ndarjen e kapaciteteve, menaxhimin e kongjestioneve dhe procedurat *anti-hoarding* (antimbledhëse, grumbulluese) dhe ato të rishfrytëzimit;

f) Rregullat që aplikohen për tregtimin e kapaciteteve në tregun dytësor në krahasim me operatorin e sistemit të transmetimit;

g) Rregullat e balancimit dhe metodologjia për përllogaritjen e detyrimeve të disbalancimit;

h) Nëse aplikohen, nivelet e fleksibilitetit dhe të tolerancës të përfshira në transport dhe shërbimet e tjera pa detyrime të veçanta, si dhe fleksibiliteti i ofruar në lidhje me këtë, si dhe detyrimet korresponduese;

i) Një përshkrim i detajuar i sistemit të gazit të operatorit të sistemit të transmetimit dhe pikave përkatëse të interkoneksionit, si përcaktohet në paragrafin 3.2 të këtyre rregullave, si dhe emrat e operatorëve të sistemeve të interkoneksionit ose të shërbimeve;

j) Rregullat që aplikohen për lidhje në sistem, të cilat operohen nga operatori i sistemit të transmetimit;

k) Informacion mbi mekanizmat e emergjencës, për sa kohë kjo është përgjegjësi e operatorit të sistemit të transmetimit, siç janë masat që mund të çojnë në shkëputjen e grupit të konsumatorëve dhe rregullave të përgjithshme të detyrimeve, të cilat aplikohen për operatorin e sistemit të transmetimit;

l) Procedurat të cilat dakordësohen nga operatorët e sistemit të transmetimit në pikat e ndërlidhjes, në lidhje me ndërveprimin me rrjetin, procedurat e rëna dakord për emërimin dhe koordinimin, si dhe procedurat e tjera të rëna dakord, të cilat përcaktojnë dispozitat në lidhje me ndarjen e rrjedhjes së gazit dhe të balancimit, përfshirë metodat e përdorura;

m) Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të publikojnë një përshkrim të detajuar dhe të kuptueshëm për metodologjinë dhe procesin, përfshirë informacionin mbi parametrat e marrë dhe supozimet kyçe të përdorura për të përllogaritur kapacitetin teknik.

3.2 Përcaktimet për të gjitha pikat për kërkesat e transparencës

1. Pikat përkatëse do të përfshijnë:

a) Të gjitha pikat e hyrjes dhe të daljes për dhe nga rrjeti i transmetimit, i operuar nga operatori i sistemit të transmetimit, me përjashtim të pikave të daljes të lidhura te një konsumator i vetëm fundor dhe me përjashtim të pikave të daljes të lidhura direkt me hapësirat e prodhimit të një prodhuesi të vetëm i cili ndodhet brenda BE-së;

b) Të gjitha pikat e hyrjes dhe të daljes që lidhen me zonat e balancimit të operatorëve të sistemit të transmetimit;

c) Të gjitha pikat të cilat lidhin rrjetin e operatorit të sistemit të transmetimit me një terminal GNL, shpërndarësit fizikë të gazit, shërbimet e depozitimit dhe të prodhimit të cilat përjashtohen sipas pikës "a";

d) Të gjitha pikat që lidhin rrjetin e një operatori të caktuar të sistemit të transmetimit për infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të balancimit si përcaktohet në nenin 2(14) të Direktivës 2009/73/EC.

2. Informacion për konsumatorët e vetëm fundorë dhe për hapësirat e prodhimit të cilat përjashtohen nga përkufizimi i pikave përkatëse, si përshkruhet në 3.2(1)(a), duhet të publikohet në format të përgjithshëm, të paktën për zonën e balancimit. Formati i përgjithshëm për konsumatorët fundorë të vetëm dhe hapësirat e prodhimit, të cilat përjashtohen nga përkufizimi i pikave përkatëse si përshkruhet në pikën 3.2(1)(a) për zbatim të këtyre rregullave, duhet të konsiderohet si një pikë e caktuar.

3. Kur pikat ndërmjet dy ose më shumë operatorëve të transmetimit menaxhohen vetëm nga operatorët e transmetimit në fjalë, pa asnjë përfshirje kontraktuale ose operacionale të përdoruesve të sistemit ose, ku pikat e lidhin një sistem transmetimi me një sistem shpërndarjeje dhe nuk ka bllokim kontraktual në këto pika, operatorët e sistemit të transmetimit do të përjashtohen për këto pika nga detyrimi për të publikuar kërkesat sipas paragrafit 3.3 të këtij aneksi. Autoriteti rregullator në vend mund t'u kërkojë operatorëve të sistemit të transmetimit që të publikojnë kërkesat sipas paragrafit 3.3 të këtyre rregullave për të gjitha grupet ose për të gjitha pikat e përjashtuara. Në këto raste, informacioni nëse është në dispozicion të OST-së, duhet të publikohet në një formë të përgjithshme në mënyrë të kuptueshme, të paktën për zonën e balancimit. Kjo formë e përgjithshme për këto pika duhet që për zbatim të këtyre rregullave të konsiderohet si pikë më vete.

3.3 Informacioni që duhet të publikohet në të gjitha pikat përkatëse dhe afati sipas të cilit ky informacion duhet të publikohet

1. Në të gjitha pikat përkatëse, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të publikojnë informacionin si përmendet në paragrafët "a" në "g", për të gjitha shërbimet dhe shërbimet ndihmëse të ofruara (veçanërisht informacionin për përzierjen, zhavorrin dhe konvertimin). Ky informacion duhet të publikohet në mënyrë numerike në afate orare ose ditore, të njëjta me periudhën më të vogël të referencës për rezervimin e kapaciteteve dhe (ri)emërimin dhe periudhën më të vogël të vendosjes sipas së cilës përllogariten detyrimet e disbalancimit. Nëse periudha më e vogël e referencës është e ndryshme nga periudha ditore, informacioni si përmendet në paragrafët nga "a" te "g" duhet të vendoset në dispozicion për periudhën ditore. Informacioni dhe përditësimet duhet të publikohen sa me shpejt tek operatori i sistemit (afër kohës reale):

a) Kapaciteti teknik për rrjedhjet në të dyja drejtimet;

b) Konfirmimi total i kontraktuar dhe kapaciteti i ndërprerë për të dyja drejtimet;

c) Emërimet dhe riemërimet për të dyja drejtimet;

d) Konfirmimi në dispozicion dhe kapaciteti i ndërprerë për të dyja drejtimet;

e) Flukset aktuale fizike;

f) Ndërprerjet e planifikuara dhe aktuale për kapacitetin e ndërprerë;

g) Ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara për shërbimet e konfirmuara, si dhe informacionin për rimëkëmbjen e shërbimeve të konfirmuara (veçanërisht, mirëmbajtja e sistemit dhe kohëzgjatja për ndërprerjet për shkak të mirëmbajtjes). Ndërprerjet e planifikuara duhet të publikohen të paktën para 42 ditësh;

h) Në rastet e kërkesave jo të suksesshme, ligjërisht të vlefshme për produktet me kapacitet të konfirmuar me një kohëzgjatje prej një muaji ose më shumë, përfshirë numrin dhe vëllimin e kërkesave të pasuksesshme; dhe

i) Në rastin e tenderave, kur dhe ku produktet e konfirmuara të kapaciteteve me një kohëzgjatje prej një muaji ose më shumë, janë shlyer me çmime më të larta se çmimi rezervë;

j) Në rastet kur dhe ku produkti i pakonfirmuar i kapacitetit me kohëzgjatje një muaj ose më shumë është ofruar në një proces të rregullt alokimi;

k) Total, kapaciteti i përgjithshëm në dispozicion, përmes aplikimit të procedurave të menaxhimit të kongjestioneve të përcaktuara në pikat 2.2.2, 2.2.3, 2.2.4 dhe 2.2.5, për procedurën që aplikohet për menaxhimin e kongjestioneve.

1. Pikat nga "h" te "k" duhet të zbatohen nga data 1 tetor 2018.

2. Te të gjitha pikat përkatëse duhet të publikohet informacioni sipas paragrafit 3.3(1)(a), (b) dhe (d) për periudhën prej të paktën 18 muajt në vazhdim.

3. Te të gjitha pikat përkatëse, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të publikojnë informacion historik mbi kërkesat e paragrafit 3.3(1)"a" deri te "g" për 5 vitet e kaluara, në mënyrë kronologjike.

4. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të publikojnë vlerat e matura të vlerave kalorifike bruto ose të treguesit *Wobbe* për të gjitha pikat përkatëse, mbi baza ditore. Shifrat paraprake duhet të publikohen e shumta pas 3 ditësh pas ditës respektive të gazit. Shifrat finale do të publikohen brenda 3 muajsh pas përfundimit të muajit përkatës.

5. Për të gjitha pikat respektive, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të publikojnë kapacitetet në dispozicion, ato të rezervuara dhe kapacitetet teknike, sipas një baze vjetore për të gjitha vitet kur është kontraktuar kapaciteti plus 1 vit dhe për të paktën 10 vitet në vazhdim. Ky informacion do të përditësohet të paktën çdo muaj ose më shpesh, nëse ka informacion të ri. Publikimi do të reflektojë periudhën për të cilën kapaciteti është ofruar në treg.

3.4 Informacioni që do të publikohet në lidhje me sistemin e transmetimit dhe afatet sipas të cilave ky informacion duhet të publikohet

1. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të ofrojnë publikimin çdo ditë dhe përditësimin e përditshëm të shumave të grumbulluara për kapacitetet e ofruara, si dhe ato të kontraktuara në tregun dytësor (siç janë ato të blera nga një përdorues rrjeti te një përdorues tjetër i rrjetit), ku informacioni vendoset në dispozicion nga OST-ja. Ky informacion përfshin specifikimet e mëposhtme:

a) Pikën e interkoneksionit ku është shitur kapaciteti;

b) Llojin e kapacitetit, siç është kapaciteti hyrës, dalës, i konfirmuar, i ndërprerë;

c) Sasinë dhe kohëzgjatjen e të drejtave të përdorimit të kapacitetit;

d) Llojin e shitjes, p.sh., transferim ose caktim;

e) Numri total i tregjeve/i transfertave;

f) Çdo kusht tjetër i njohur nga operatori i sistemit të transmetimit si përmendet në 3.3.

Deri më tani ky informacion është dhënë nga një palë e tretë, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të përjashtohen nga kjo dispozitë.

2. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të publikojnë kushte të harmonizuara sipas të cilave do të pranohen transaksionet e kapacitetit (p.sh., transfertat dhe caktimet). Këto kushte të paktën

duhet të përfshijnë:

a) Një përshkrim të produkteve të standardizuara të cilat mund të shiten në tregun dytësor;

b) Kohën për zbatimin/pranimin/regjistrimin e tregjeve dytësore. Në rast vonesash duhet të publikohen arsyet;

c) Njoftimi për operatorin e sistemit të transmetimit nga shitësi ose palët e treta referuar 3.4(1) për emrin e shitësit dhe të blerësit dhe specifikimet e kapacitetit si theksohen në 3.4(1).

Për aq kohë sa ky informacion ofrohet nga një palë e tretë, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të përjashtohen nga kjo dispozitë.

3. Në lidhje me shërbimin e balancimit të sistemit, çdo operator i sistemit të transmetimit duhet t'i ofrojë çdo përdoruesi të rrjetit, për çdo periudhë balancimi, vëllimet e veçanta paraprake të disbalancave dhe të dhënat e kostot për çdo përdorues individual të rrjetit, e shumta 1 muaj pas përfundimit të periudhës së balancimit. Të dhënat finale të konsumatorëve që furnizohen sipas profileve të standardizuara të ngarkesës mund të ofrohen pas 14 muajsh. Për aq kohë sa ky informacion ofrohet nga një palë e tretë, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të përjashtohen nga kjo dispozitë. Ofrimi i këtij informacioni duhet të respektojë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar.

4. Kur ofrohen shërbime fleksibël, përveç tolerancave për aksesin e palëve të treta, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të publikojnë parashikimet ditore në ditën në avancë për vlerën maksimale fleksibël, nivelin e rezervuar të fleksibilitetit dhe disponueshmërinë e fleksibilitetit për tregun për ditën tjetër të gazit. Operatori i sistemit të transmetimit duhet të publikojë informacionin aktual (*ex- post*) mbi shfrytëzimin e agregatit për çdo shërbim fleksibiliteti në fund të çdo dite të gazit. Nëse autoriteti rregullator është i kënaqur që ky informacion krijon mundësinë e abuzimit të mundshëm nga përdoruesit e rrjetit, ai mund të vendosë të përjashtojë operatorin e sistemit të transmetimit nga ky detyrim.

5. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të publikojnë për çdo zonë balancimi sasinë e gazit në sistemin e transmetimit çdo fillim dite dhe duhet të parashikojnë sasinë e gazit në sistemin e transmetimit në fund të çdo dite. Sasia e parashikuar e gazit, në fund të çdo dite, duhet të përditësohet çdo orë përgjatë ditës. Nëse llogariten detyrimet e disbalancave çdo orë, operatori i sistemit të transmetimit duhet ta publikojë sasinë e gazit në sistemin e transmetimit çdo orë. Në të kundërt, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të publikojnë për çdo zonë balancimi pozicionin e agregatit për disbalancimin për të gjithë përdoruesit në fillim të çdo periudhe balancimi dhe parashikimin e pozicionit të agregatit për disbalancimin për të gjithë përdoruesit në fund të çdo dite. Nëse autoriteti rregullator është i kënaqur që ky informacion mund të krijojë mundësinë e abuzimit të mundshëm nga përdoruesit e rrjetit, ai mund të vendosë të përjashtojë operatorin e sistemit të transmetimit nga ky detyrim.

6. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet t'i ofrojnë përdoruesit instrumente të favorshme për llogaritjen e tarifave.

7. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të mbajnë në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vend, për të paktën 5 vjet, të dhënat efektive për të gjitha kontratat e kapaciteteve dhe informacionet e tjera përkatëse në lidhje me llogaritjen dhe ofrimin e aksesit për kapacitetet në dispozicion, në mënyrë të veçantë caktimet dhe nominimet individuale. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të mbajnë të gjithë informacionin sipas pikës 3.3(4) dhe (5) për të paktën 5 vjet dhe ta vendosin atë në dispozicion të autoritetit rregullator sipas kërkesës. Të dyja palët duhet të respektojnë konfidencialitetin tregtar.

4. Afatet për zbatim të dispozitave të këtyre rregullave

4.1 Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të harmonizojnë procedurat për formalizmin e kërkesës dhe afatet për të kthyer përgjigje sipas praktikave më të mira të industrisë për të minimizuar afatet për përgjigje. Ata duhet të ofrojnë rezervimin e kapacitetit *online*. Sistemet e konfirmimit dhe procedurat e emërimit/ riemërimit jo më vonë se data 1 korrik 2018, pasi të jenë konsultuar me përdoruesit përkatës të

rrjetit.

4.2 Në bazë të informacionit të publikuar nga operatorët e sistemit të transmetimit, sipas pjesës 3 të këtyre rregullave dhe, kur është e përshtatshme, të vlefshme nga autoritetet rregullatore në vend, agjencia duhet të publikojë deri në datën 1 mars të çdo viti, duke filluar nga viti 2020, një raport monitorimi mbi kongjestionet në pikat e ndërlidhjes, në lidhje me produktet e konfirmuara të kapacitetit, të cilat janë shitur gjatë vitit në vijim, duke marrë në konsideratë shkallën e mundshme të tregtimit të kapaciteteve në tregun sekondar dhe përdorimin e kapacitetit të ndërprerjes.

4.3 Masat e vendosura në pikat 2.2.2, 2.2.4 dhe 2.2.5 duhet të zbatohen duke filluar nga data 1 tetor 2018. Pikat nga 2.2.3(1) te 2.2.3(5) duhet të aplikohen deri në datën 1 korrik 2020.

4.4 Përdoruesi i rrjetit përdor më pak se mesatarisht 80% e kapacitetit të tij të kontraktuar nga 1 prilli deri në datën 30 shtator dhe nga 1 tetor deri në 31 mars me kohëzgjatje efektive të kontratës prej më shumë se një vit, për të cilin nuk mund të jepen arsyetimet e duhura; ose

4.5 Operatorët e sistemit të transmetimit të gazit natyror duhet të ofrojnë të gjithë informacionin referuar në paragrafin 3.1.2 dhe paragrafin 3.3(1) deri 3.3(5), sipas mënyrës së përcaktuar në paragrafin 3.1.1 të këtyre rregullave;

4.6 Pika 3.3.1, nga germa "h" te germa "k" duhet të zbatohen nga data 1 tetor 2018.

4.7 Informacioni që duhet të publikohet në të gjitha pikat përkatëse sipas parashikimeve të paragrafit 3.3 të këtyre rregullave.

4.8 Këto rregulla hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit nga bordi i ERE-s